




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, kk.rks-gov.net/gjilan, info.gjilan@rks-gov.net tel. 0280 320 781, 0280 320 782, 321 482, 321 483

Në mbështetje të nenit 38 paragrafi 1.4, nenin 46 paragrafi 2.3 dhe nenin 82 paragrafi 2 të Statutit të Komunës së Gjilanit 01. nr. 16-126211 dt. 06.11.2014, si dhe mbështetur në pikën III. të Vendimit 01. nr. 016-72583 dhe pikën III. të vendimit 01.nr.016-72577 dt. 27.06.2014 për emërimin e anëtarëve të Komisionit Komunal të Aksionarëve në NPL "Stacioni i Autobusëve" dhe në Kompaninë "Eco Higjiena", Kuvendi i Komunës së Gjilanit në mbledhjen e mbajtur me 02.12.2014, merr:

V E N D I M
PËR CAKTIMIN E LARTËSISË SË KOMPENSIMIT MUJOR PËR ANËTARËT E
KOMISIONEVE KOMUNALE TË AKSIONARËVE

1. Me këtë vendim caktohet lartësia e kompensimit mujor për anëtarët e komisionit Komunal të Aksionarëve në NPL "Stacioni i Autobusëve" dhe për anëtarët e Komisionit Komunal të Aksionarëve në Kompaninë "Eco-Higjiena" (për pjesën publike të Kompanisë "Eco Higjiena") në Gjilan.
2. Shuma e kompensimit të rregullt mujor për secilin anëtarë të Komisionit Komunal të Aksionarëve në të dy ndërmarrjet caktohet në lartësi prej 100,00 € (njëqind euro) si dhe plus 50€ (pesëdhjetë euro) për çdo takim të mbajtur, por jo më shumë se për dy takime brenda muajit.
3. Deri në hyrjen në fuqi të këtij vendimi, anëtarët e Komisioneve Komunale të aksionarëve në të dy ndërmarrjet Publike Komunale si në pikën 1. të këtij vendimi paguhën në mënyrë ekuivalente siç janë paguar anëtarët e mëhershëm të Komisioneve Komunale të aksionarëve me vendimin 01.Nr.16-53257 të datës 13.06.2013
4. Mjetet për kompensimin anëtarëve të Komisionit komunal të aksionarëve ndahen nga Buxheti i Komunës-Kodi buxhetor i pagave dhe mëditjeve të Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik,.
5. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari I komunës dhe Drejtoria për Zhvillim Ekonomik, ndërsa për monitorim të zbatimit kujdeset Kryesuesi I KK-Gjilan.
6. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës,

01.Nr. 016-134652
Gjilan, më 02.12.2014

Kryesuesja e Kuvendit,

Valentina Bunjaku-Rexhepi